

AKT THEMELIMI

i Shoqërisë "X.ALB" Sh.p.k.

Sot, me datë 03 / 03 / 2025,

Z. Francesco Calabro, shtetas italian, lindur më 28.12.1976, në Porto San Giorgio (FM), banues në Itali, mbajtës i dokumentit pasaporte me nr. YB4205762, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Znj. Marta Sbrascia, shtetase italiane, lindur më 06.01.1986, në Fermo (AP) banuese në Itali, mbajtës i dokumentit pasaporte me nr. YC7121496, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Z. Giacomo Tossici, shtetas italian, lindur më 27.12.2000, në Fermo (AP), banues në Itali, mbajtës i dokumentit pasaporte me nr. YC2170204, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kemi vendosur të themelojme një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**X.ALB**" (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1 EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**X.ALB**"



NENI 2 SELIA

Shoqëria ka seli në Tiranë, në adresën: Njesia administrative nr. 5, 1019, Rruga Birgada VIII, Ndertesa nr 23, Hyrja 5, Tirane, Shqiperi.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.



NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Studim, projektim, mbikqyrje, kolaudim, konsulence per ndertim e zbatim te veprave ndertimore publike dhe private, objekte turistike, ushtarake, kulti, industriale dhe te veprave ndertimore te te gjitha llojeve sipas legjislacionit; Studime urbanistike te te gjitha niveleve; planifikim urban; projektim arkitektonik; projektim fotogrametrik, hartografik, topografik; sherbime konsulence tekniko-ekonomike te ndryshme sipas kategorive dhe nenkategorive te licensave profesionale dhe cdo lloj studimi dhe projektimi. Studime fizibiliteti; vleresim te pasurive te paluajtshme, vleresime mjedisore. Menaxhim dhe administrim pronash dhe objektesh. Blerje-shitje pasuri te paluajteshme. Shoqeria mundet gjithashtu te ushtroje cdo lloj tjeter biznesi apo aktiviteti te ligjshem dhe/ose mund te angazhohet ne cdo veprimtari te ligjshme ose aktivitet te lejueshem nga legjislacioni shqiptar ne fuqi. Ne pergjithesi shoqeria mund te kryeje cdo veprimtari te nevojshme e te dobishme te lejuar nga ligji per relizimin e objektit te aktivitetit te saj. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike etj...


NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakeve themelues në vlerën 100.000 (një qind mije) Lekë dhe përbëhet nga 3 (tre) kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Francesco Calabro**, zoteron 1 kuotë, me 40% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 40.000 (dyzet mije) Lekë dhe 40.000 (dyzet mije) Lekë të kapitalit themeltar.
- **Znj. Marta Sbrascia**, zoteron 1 kuotë, me 40% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 40.000 (dyzet mije) Lekë dhe 40.000 (dyzet mije) Lekë të kapitalit themeltar.
- **Z. Giacomo Tossici**, zoteron 1 kuotë, me 20% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 20.000 (njetzet mije) Lekë dhe 20.000 (njetzet mije) Lekë të kapitalit themeltar.



Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra me shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

-Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

-Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z.Francesco Calabro**, shtetas italian, lindur më 28.12.1976, në Porto San Giorgio (FM), banues në Itali, mbajtës i dokumentit pasaporte me nr. YB4205762, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE


Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë duke autorizuar Administratorin, **Z. Ismet Dybeli**, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKET THEMELUES

Francesco Calabro

Francesco Calabro


Marta Sbrascia

MARTA SBRASCIA


Giacomo Tossici

Giacomo Tossici
